



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 49/2022 (JR)
Nr. 49/ 2 regj.

Tiranë më 27.07.2023

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e mërkurë, datë 27.09.2023, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 49/2022, datë 22.11.2022, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Edmond Shtytko kundër vendimit nr. 566, datë 28.09.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtaret:

Kryesuese e trupit gjykses
Relatore e çështjes
Anëtare
Anëtare
Anëtar

Albana Shtylla
Mimoza Tasi
Ina Rama
Natasha Mulaj
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

Albana SHTYLLA

